

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I PËR APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-02/12

**Prishtinë,
1 nëntor 2011**

Në çështjen juridike të:

J.M.

Paraqitësja e kërkesës/Pala ankuese

Kundër

E.B.

Pala përgjegjëse në kërkesë/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit i AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët : Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Filcheva-Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, Anëtarë, duke vendosur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit i Kërkesave Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/122/2011 (lënda është regjistruar në

AKP me numrin KPA30510), të datës 07 shtator 2011, pas shqyrtimit të mbajtur me 1 nëntor 2012, mori këtë

AKTGJYKIM

- 1- **Anulohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/122/2011, i datës 07 shtator 2011, për sa i përket lëndës së regjistruar me numrin KPK30510, për shkak të jokompetencës.**
- 2- **Hedhet poshtë kërkesë e J.M., e regjistruar me numrin KPA30510, për shkak të mungesës së juridiksionit të AKP-së.**
- 3- **Obligohet pala ankuese që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 60 € (gjashtëdhjetë euro), të cilat duhet të paguhen në Buxhetin e Kosovës brenda afatit prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.**

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Me 08 mars 2007, J.M. ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku ka kërkuar që të njihet si pronar i banesës në sipërfaqe prej 76.30 metrave katror, që gjendet në Vushtri, rruga Vidovdanska nr.124, kati i katërt, banesa nr. 22. Ajo ka pohuar se është pronare e banesës në bazë të kontratës së shitblerjes të datës 4 korrik 1997, e cila është vërtetuar nga Gjykata Komunale në Vushtri Vr.nr.34/2004, e datës 10 qershor 2004, dhe se prona e sajë ishte uzurpuar. Ajo ka theksuar se në zyrën e DPÇPB-ës, ka paraqitur kërkesë për banesën, por nuk është njoftuar për statusin momental lidhur me zgjidhjen e asaj kërkesë. Ajo pretendon se e kishte humbur posedimin e pronës me 1 qershor 1999.

Për të mbështetur kërkesën e saj, ajo ka paraqitur dokumentet si në vijim:

- Aktvendimin e dhënjes së banesës në shrytëzim nga S.H.A “Industria e Tekstilët Polet”, nga Vushtria nr. 18/K, i datës 28 janar 1994;
- Kontratën për blerjen e banesës, të lidhur ndërmjet kompanisë së sipërcekur si shitës dhe paraqitëses së kërkesës si blerës, nr.74/K, e datës 14 korrik 1994, të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Vushtri, me datë 10 qershor 2004, dhe
- Letërnjoftimin, e datës 28 prill 2005, të lëshuar nga Ministria e Punëve të Mbrendshme të Serbisë.

E njejta banesë ka qenë objekt i shqyrtimit të Komisionit të Kërkesave Pronësore Banesore, që i referohet kërkesës së S.M. - nuses së djalit të sajë, e regjistruar me nr. DS301037, me datë 28 korrik 2005.

Sipas vendimi grupor të këtij Komisioni nr. HPCC/D/204/2005/60, i datës 18 qershor 2005, kërkesa e S.M., refuzohet, me arsyetim se ajo nuk ka vërtetuar të drejtë e pronësisë në banesën e kërkuar. Përkatësisht ekipi verifikues i Sekretarisë Ekzekutive të AKP-ës nuk ka mundur të gjejë këto dokumente (vendimin dhe kontratë) koresponduese qoft në origjinal apo kopje në Kuvendin Komunal të Vushtrrisë, në Ndërmarrjen Publike Banesore, ose në Gjykatën Komunale në Vushtri, si organe kompetente për lëshimin e këtyre dokumenteve.

Njoftimi i pronës është bërë me 27 prill 2009. Prona e kërkuar është gjetur e uzurpuar nga E.B., i cili ka nënshkruar njoftimin mbi pjesëmarrjen në procedurë, me datë 5 nëntor 2011, duke pretenduar të drejtë ligjore për pronën e kërkuar.

Pala përgjegjëse në kërkesë për t'i mbështetur pretendimet e tija si titullar i së drejtës për këtë banesë ka paraqitur këto dokumente apo prova të vlefshme juridikisht relevante:

- Aktvendimin për ndarjen e banesës të lëshuar nga Fabrikës së Tekstillit "Polet", nga Vushtria nr. 069, i datës 16 dhjetor 1997;
- Kontratën e Qirasë me Fabrikën e Tekstillit "Polet", nga Vushtria nr. 069/1, e datës 16 dhjetor 1997;
- Kontratën e Shitjes së banesës me Fabrikën e Tekstillit "Polet", nga Vushtria nr. 069, e datës 03 dhjetor 1998;
- Fletëpagesën nga Fabrika e Tekstillit "Polet", nga Vushtria me nr. 6250, e datës 27 gusht 2007, me të cilën konstatohet pagesa e çmimit të blerjes së banesës;
- Faturën e energjisë elektrike në emër të tijë DMI-30034, e datës 25 shtator 2008, dhe
- Faturën e tatimit në pronë në emër të tij nr.595677, e datës 25 shtator 2008.

Të gjitha këto dokumente nga Ekipi Verifikues i AKP-ës janë verifikuar pozitivisht në organet kompetente të cilat edhe i kanë lëshuar ato, apo të njejtat janë depozituar apo arhivuar sipas *detyrës zyrtare*.

Me 7 shtator 2011, KKPK-ja në vendimin e tij KPCC/D/R/122/2011 e ka refuzuar kërkesën. KKPK-ja ka konstatuar se paraqitësi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë provë ligjore se ajo është pronare legjitime, përkatësisht me prova juridikisht të vlefshme nuk ka vërtetuar të drejtën pronësore në pronën e kërkuar.

Vendimi i është dorëzuar paraqitëses së kërkesës me 13 dhjetor 2011. Me 4 janar 2012, ajo ka paraqitur një ankesë.

Palës përgjegjëse ankesa i është dorëzuar me 12 dhjetor 2011, dhe nuk ka paraqitur përgjegjeje në ankesë.

Arsyetim ligjor:

Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda afatit prej 30 ditëve siç parashihet me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079.

Gjykata Supreme, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të dosjes, vendimit të ankimuar si edhe pretendimeve ankimore gjen se, vendimi ankimor është me shkelje thelbësore të dispozitave të nenit 182 paragrafi 2 nëparagrafi (B) të LPK-ës, e cila përshtatshmërisht zbatohet sipas nenit 12 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079. Prandaj, i njëjti vendim i KKPK-ës, sipas nenit 198 paragrafi 1 i LPK-ës duhet të anulohet dhe kërkesa e paraqitëses së kërkesës të hedhet poshtë. Kjo pikërisht për asye se e njëjta çështje juridike pronësore nuk bjen në jurisdiksonin e Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe rrjedhimisht të Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme. Prandaj, pasur parasysh se ky vendim është i natyrës procedurale – për shkak të mungesës së jurisdiksonit ndaj edhe nuk është vendosur për bazueshmërinë, përkatësisht në meritat e tij.

Kjo pikërisht për arsye se, sipas nenit 3.1 Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në një urdhëresë nga Komisioni për ri-posedim të pronës nëse, paraqitësi i kërkesës jo vetëm që dëshmon pronësinë e pronës së paluajtshme private, por edhe që, ai apo ajo nuk është në gjendje aktualisht t'i ushtrojë këto të drejta pronësore për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërsëdrejti apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet periudhës kohore 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

Për të njëjtën banesë fillimisht ka paraqitur kërkesë nusja e djalit të praqitëses së kërkesës S.M. të regjistruar në DPÇPB me nr. DS301037. Ndërkaq, me vendimin e HPCC/D/204/C i datës 18 qershor 2005, është refuzuar kjo kërkesë, me arsyetim se dokumentacioni i paraqitur nga paraqitësi i kërkesës nuk është gjetur në arhivat e organeve dhe institucioneve përgjegjëse dhe kështu nuk ka provuar të drejtën pronësore në banesën e kërkuar me dokumente valide dhe relevante. Në ndëkohë, po për këtë banesë, kërkesë ka paraqitur J.M. në cilësinë e titullarit të së drejtës së banesës kontestuese. Me 7 shtator 2011, KKPK-ja në vendimin e tij KPCC/D/R/122/2011 e ka refuzuar kërkesën. KKPK-ja ka konstatuar se paraqitësja e kërkesës nuk ka siguruar e as që ka deponuar ndonjë provë ligjore se ajo është pronare legjitime, përkatësisht nuk ka paraqitur prova juridikisht të vlefshme për të vërtetuar të drejtën pronësore për pronën e kërkuar.

Prandaj, mund të konkludohet se kontesti lidhur me pronën në fjalë as nuk rrjedh, e as nuk është i ndërlidhur drejtpërsëdrejti me konfliktin e armatosur të 1998/1999.

Lënda ishte jashtë fushëveprimit të juridiksionit të AKP-së, dhe se KKPK-ja nuk është dashur të vendos për merita, por është dashtë të hedh poshtë atë. Kjo nuk është bërë, prandaj edhe KKPK-ja ka marrë një vendim të pavlefshëm, i cili duhet të anulohet sipas nenit 198.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Sipas dispozitës ligjore të referuar, kur gjykata e shkallës së parë (në këtë rast është organ pothuajse gjyqësor) merr një vendim jashtë juridiksionit të saj, gjykata e shkallës së dytë duhet ta anulojë vendimin dhe ta hedhë poshtë kërkesën.

Këto dispozita të Ligjit për Procedurën Kontestimore zbatohen përshtatshëm në procedurën e Kolegjit të Apelit të AKP-ës të Gjykatës Supreme, sipas nenit 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.

Për faktin se, kërkesa me vendim është hedhur, për shkak të mungesës së juridiksionit të Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave Pronësore, dhe rrjedhimisht të Gjykatës Supreme, del se shqyrtimi dhe vlerësimi i kërkesës, përgjegjes në kërkesë dhe ankesës, që i referohet vlefshmërisë dhe meritave, është i penavojshtëm.

Shpenzimet e procedurës:

Në përputhje me Shtojcën III, nenin 8.4 të Urdhëresës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, palët përjashtohen prej shpenzimeve të procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Ndërkaq një përjashtim i tillë nuk parashikohet në procedurën para Kolegjit të Apelit. Rrjedhimisht, regjimi normal i shpenzimeve gjyqësore siç parashihet me Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK, 3 tetor 1987) dhe sipas UA nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore, zbatohet ndaj procedurës së zhvilluar para Kolegjit të Apelit.

Prandaj, shpenzimet gjyqësore si në vijim aplikohen në procedurën e tanishme të ankesës:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa nga tarifa gjyqësore për marrjen e aktgjykimit (nenet 10.21 dhe 10.15 të UA 2008/2), që është më së shumtë 30 €.

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga pala ankuese që ka humbur rastin. Në përputhje me nenin 46 të Ligjit mbi Shpenzimet Gjyqësore, afati për pagesën e taksave në fjalë nga personi i cili ka vendqëndrim ose vendbanim jashtë vendit nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 (tridhjetë) ditë e më i gjatë se 90 (nëntëdhjetë) ditë. Gjukata vendos që në rastin tanishëm tarifat gjyqësore duhet të paguhën nga pala ankuese brenda 90 (nëntëdhjetë). Neni 47.3 parasheh së në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, pala

duhet të paguajë një gjobë prej 50% të shumës së taksës. Nëse pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë atëherë bëhet zbatimi i detyrueshëm i pagesës.

Këshillë juridike:

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjete juridike të rregullta dhe të jashtëzakonshme.

Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX-it